




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE



24/06/2024

Nr. i Protokollit: 02/ 685

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Gjurokoc

E enjte, më 19 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: 17:30 – 19:00

Vendi i takimit: SHF "Lasgush Poradeci"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emiri, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- Besnik Ahmeti si dhe Asambleistët- Sanie Sadiku, Zejnie Veliu dhe Besnik Seferi.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi : Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Ky takim ka të bëjë me Kornizën Aftatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, ne i kemi mbajtur po thujse dëgjimet publike në të gjitha fshatrat na kanë mbetur edhe disa fshatra për t'i përfunduar të gjitha. Ju si banorë i dini problemet e fshatit Gjurokoc, po ashtu këtu e kemi edhe Kryetarin e fshatit i cili i din problemet edhe Asambleistin Rexhep Gashi. Korniza Afatmesme Buxhetore për çdo vit po ka rritje në Komunën e Shtimes, vitin e kaluar kur ishim bashk këtu ishte afër 10 milion ndërsa këtë vit është afër 11 milion, do të thotë është buxheti lokal pa i përmendur investimet nga niveli qendror. Ju e dini që shumica e buxhetit mbi 50% shkon në paga dhe mëditje në Komunën e Shtimes, pjesa tjetër e buxhetit është mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe subvencione ku për vitin 2025 do të kemi një rritje nga 350 mijë në 500 mijë.

Tek investimet kapitale vitin e kaluar i kemi pasur 2 milion e 300 mijë ndërsa këtë vit shkon afërsisht 2 milion e 700 mijë dhe kësaj buxheti i Komunës së Shtimes nga të gjitha kategoritë të cilat i përmenda do të jetë afër 11 milion.

Ne si qeverisje e kemi edhe obligim ligjor t'i mbajmë dëgjimet publike me qytetarët dhe bashkarisht ta ndërtojmë buxhetin për vitin 2025. Secilin fshat i kemi marr kërkesat, ato kërkesa jo të gjitha mund t'i vendosim në buxhet pasi që e kemi buxhetin e limituar pra duhet kërkesat të cilat janë më primare t'i vendosim. Nuk duhet harruar të përmendet edhe granti i performancës të cilin ne si komunë e kemi fituar që ka vlerën prej 400 mijë euro, ky grant do të bëhet i tëri ndriçim në Komunën e Shtimes, fshatrat për rreth dhe lagjet urbane.

Nuk dua të zgjasem dhe shumë që të flas për projekte të cilat këto dy vite qeverisje i kemi nis, disa të tjera janë në procedura të prokurimit, përshembull e kemi tranzitin që së bashku me ministrinë e linjës e kemi përfunduar, unaza tani përfundon në fund të muajit, e kemi nënshkruajtur një

memorandum që do ta bëjmë edhe një unazë e cila e lidh rrugën “William Woker”, dhe rrugën “12 Qershor”, që ta lehtësojmë trafikun rrugor. Kemi filluar me stadiumin ku vlera e këtij stadiumi është 2 milion e gjysëm, kemi renovuar disa shkolla disa të tjera janë në proces e sipër, çerdhja në fshatin Godanc ku punimet e vrazhda kanë përfunduar, kemi hap QKMF-në e fshatit Pjetërshticë, Petrovë edhe Godanc, po mendojmë që të ndërtojmë edhe QKMF-në e re në Shtime, do ta dislokojmë entin special këto janë disa nga projektet të cilat janë në procedura. Këtu sot ne jemi për një qëllim që t'i marrim kërkesat e juaja dhe ato kërkesa t'i vendosim në buxhet.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- Nazif Sadriu: “Besim Sopa”, rruga është shumë e ngusht dhe duhet të zgjerohet. Shkolla duhet të rinovohet pasi nga çatia e shkollës kur ka reshje pikë. Oborri i shkollës është pa rrethoja dhe është e nevojshme të rrethekohet, po ashtu është i nevojshëm edhe rregullimi i oborrit. Si fshat kemi problem me energjinë elektrike, është shumë e dobët, po ashtu edhe shtyllat i kemi në gjendje shumë të keqe. Rruga “Gjergjaj”, “Hoxhë Sinani”, “Lagjia Hoxhaj”, të asfaltohen. Në fshatin tonë po ashtu kemi probleme edhe me kanalizim. Kemi edhe një kërkesë tjetër fusha e sportit në fshatin Gjurkovc duhet të dislokohe për shkak të zhurmave të cilat po krijohen deri në orët e vona. Ndiriçimi në të gjithë fshatin.
- Aziz Haxha: Të dislokohe fusha e futbollit në fshatin Gjurkovc.
- Bajram Haxha: Rruga “Arifi”, shtëpia nr: 93, kemi probleme me kanalizim, kur uji mbliidhet komplet futet në shtëpi po ashtu në puse edhe në oborre, prandaj ky problem duhet sanuar sa më parë. Shkolla e fshatit tonë fare nuk i ngjason një shkolle të rregullt prandaj duhet të bëhen renovime si në objekt ashtu edhe në oborr. Rryma në fshat është në gjendje shumë të keqe dhe të dobët.
- Liridon Krasniqi: Në rrugën “Fehmi Agani”, as nuk ka ndiriçim dhe as trotuar (500m). Klasat në shkollë janë shumë të vogla për tu mbajtur mësimi, disa prej klasave janë të mykura dhe nuk mund të realizohet mësimi në ato klasa. Oborri i shkollës duhet rregulluar gjithashtu edhe rrethojat e shkollës.
- Rexhep Gashi: Tek familja “Haxha”, duhet të hiqet fusha e futbollit pasi që ka probleme me zhurmën e cila zhvillohet për çdo natë në atë fushë. Të asfaltohet rruga e cila fillon nga “Ibrahim Rugova”, deri tek rruga “Fehmi Agani”. Kanalizimi nuk është funksional në fshatin Gjurkovc, tokat të cila janë toka bujqësore nuk mund të punohen si shkak i kanalizimit jo funksional. Rrethoja e shkollës është prioritet. Nga rruga “Fehmi Agani”, deri tek rruga “Besim Sopa”, duhet të rregullohet ndiriçimi.

Rruga "Hoxhë Sinani", ndriçim.

- Hysen Hoxha: në rrugën e "Hoxhë Sinani", në lagjen time pres që asfaltit të ju vendoset një shtresë e hollë që të menjanoj prishjen më shumë.

Kur ka vërshime mblidhet uji i cili e ka grryer asfaltin, atë shtrat të asaj procke të lumit duhet ta mirëmbani, të bëhet një shtrat në mënyrë që mos priset më shumë.

Trotuari dhe ndriçimi i rrugës "Hoxhë Sinani",


Rruga deri tek varrezat duhet të mirëmbahet dhe të vijë në nivelin e duhur jo të lihet siç është.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Gjurkocë
Date: 19/06/2024

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nenshkrimi |
|----|-----------------------|----------------|
| 1 | Muharrem H.YSEN HAXHA | Haxha H. |
| 2 | Nasir SADRIU | Nasir Sadiu |
| 3 | Gëzim Alin | Gëzim Alin |
| 4 | Linden Haxha | Linden Haxha |
| 5 | Asan Haxha | Asan Haxha |
| 6 | BAJRAM Haxha | Bajram Haxha |
| 7 | Behar Gashi | Behar Gashi |
| 8 | FIKRET HURDINI | Fikret Hurdini |
| 9 | ASIF HAXHA | Asif Haxha |
| 10 | | |
| 11 | | |
| 12 | | |
| 13 | | |
| 14 | | |
| 15 | | |
| 16 | | |
| 17 | | |